



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1168/3 Prot

Tiranë, më 30.6.2022

VENDIM

Nr. 18, datë 30.6.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1168 Prot., datë 10.06.2022, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Avokatura e Shtetit” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në cilësinë e kërkuesit, ankuesi, bazuar në një njoftim me titullin “Njoftim – Ftesë për ofertë/Notification – Call for Offers” të publikuar nga Avokatura e Shtetit në datën 12.05.2022 në websit-in e saj (<http://www.avokaturashtetit.gov.al/njoftime-3>), në të cilën citohej se: “*Në bazë të këtij njoftimi, çdo palë e interesuar mund të kërkojë informacion më të detajuar si dhe formatin e plotë të ftesës për ofertë...*”, nëpërmjet e-mail-it datë 26.05.2022, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni i detajuar mbi këtë objekt, si dhe formatin e plotë tip për këtë procedurë.

Koordinatorja për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, me e-mail-in datë 09.06.2022, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “*Në bazë të pikës 4, Seksioni A, Kreu III i VKM-së nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”, Ftesa për Ofertë përbën një dokument të cilin, Komisioni e vendos në dispozicion ekskluzivisht vetëm ndaj subjektit, që shpreh interesin për të marrë pjesë në procedurën e kontraktimit, procedurë e cila është konfidenciale.*

Afati për shprehjen e interesit për të marrë pjesë në procedurën e sipërcituar, duke kërkuar formatin e plotë të ftesës për ofertë, si dhe për të dorëzuar ofertën përkatëse ka qenë data 23.5.2022 dhe vetëm brenda kësaj date mund të vihej në dispozicion Ftesa për Ofertë, tek subjektet e interesuar.”

Pas përgjigjes së dhënë, ankuesi pretendon se: *“Citimi i bërë nga ana e Avokaturës së Shtetit nuk është i saktë, për shkak se procedura e cituar në kthimin e përgjigjes është tërësisht e ndryshme nga ajo e ndjekur në publikimin e faqes së saj. Nga njëra anë flitet për sa i përket kërkesës të çdo pale të interesuar për kontaktim për marrje të dokumentave informative të tenderit, në anën tjetër (në VKM) flitet për një procedurë më të mbyllur ku Komisioni i përcjell dokumentet vetëm subjekteve të përzgjedhur.*

Edhe për sa i përket përmbajtjes së informacionit i cili duhej të bëhej publik sipas përcaktimeve të kësaj pike të VKM-së, Avokatura e Shtetit ka shkelur VKM-në për sa kohë në thirrjen e publikuar nuk përmbahen pikat e cituara në këtë pikë si: “Njoftimi përmban minimalisht objektin e procedurës së kontraktimit, llojin e shërbimit të kërkuar, si dhe të gjithë informacionin e nevojshëm që u jep mundësi subjekteve të interesuara të shprehin interesin e tyre për të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi.”

Në rastin në fjalë, në asnjë pikë në thirrjen e hapur nuk thuhet që informacioni do të dërgohet vetëm në formë preferenciale, por do të dërgohet për çdo subjekt të interesuar. Edhe për sa i përket datës së cituar nga ana e Avokaturës së Shtetit për vënien në dispozicion të dokumentave, ftesa në fjalë përcakton vetëm datën e depozitimit të ofertave nga ana e palëve të interesuara. Në asnjë rast nuk përfshihet një afat përfundimtar për marrjen e informacionit të kërkuar nga palët e interesuara.”

Në këto kushte, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit duke kërkuar ushtrimin e kompetencave, që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të cituar në kërkesën për informacion.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri me shkresën nr. 1168/1 prot., datë 13.06.2022, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 646/11 Prot., datë 20.06.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1168/2 Prot., datë 21.06.2022, ka sqaruar se: *“...nëse kërkuesi do të paraqeste kërkesën e tij brenda afateve të përcaktuara në njoftim, ai do të ishte pajisur më formatin e plotë të ftesës për ofertë sipas përcaktimeve sa më sipër dhe në mënyrë të*

barabartë si të gjithë kërkuessit e tjerë, të cilët në zbatim të njoftimit datë 12.05.2022 kanë paraqitur kërkesën e tyre”.

Në përfundim, pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga ana e Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.* Në kuptim të këtij parashikimi, Avokatura e Shtetit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundur realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar konstatohet se, procedura e prokurimit objekt ankimi, është zhvilluar bazuar në VKM-në nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”, por, pavarësisht legjislacionit të aplikueshëm për zhvillimin e procedurave të kontraktimit, si dhe përjashtimit të Autoritetit Publik nga zbatimi i Ligjit për prokurimin publik, Komisioneri vlerëson se ky fakt nuk passjell përjashtimin e këtij autoriteti nga zbatimi i LDI.

Autoriteti Publik, fillimisht pretendon se ky informacion nuk mund të vendoset në dispozicion pasi bazuar në pikën 4, Seksioni A, Kreu III i VKM-së nr.893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”: *Ftesa për Ofertë përbën një dokument të cilin, Komisioni e vendos në dispozicion ekskluzivisht vetëm ndaj subjektit, që shpreh interesin për të marrë pjesë në procedurën e kontraktimit, procedurë e cila është konfidenciale.*

Ndërkohë, pika 4 e Seksionit A, Kreu III i VKM-së sipërcituar parashikon se: *“4.Komisioni, në ditën e dërgimit, sipas pikës 3, të këtij seksioni, publikon në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit njoftimin për nevojën e kontraktimit të subjekteve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi. Njoftimi përmban minimalisht objektin e procedurës së kontraktimit, llojin e shërbimit të kërkuar, si dhe të gjithë informacionin e nevojshëm që u jep mundësi subjekteve të interesuara të shprehin interesin e tyre për të*

marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi. Në vijim të shprehjes së interesit nga subjektet për të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi, komisioni i dërgon (me shkrim ose në formë elektronike) subjektit të interesuar ftesën për ofertë.

Nga analizimi i kësaj pike të dispozitës rezulton qartë se Autoriteti Publik ka bërë një interpretim të gabuar të saj pasi, ashtu si edhe citohet më sipër, një pjesë e informacionit objekt ankese përkon me informacionin që duhet të ishte pjesë e shpalljes së bërë nga ky autoritet, në funksion kjo të procedurës së zhvilluar.

Ndërkohë, lidhur me argumentin e Autoritetit Publik se: “...nëse kërkuesi do të paraqeste kërkesën e tij brenda afateve të përcaktuara në njoftim, ai do të ishte pajisur më formatin e plotë të ftesës për ofertë sipas përcaktimeve sa më sipër dhe në mënyrë të barabartë si të gjithë kërkuesit e tjerë, të cilët në zbatim të njoftimit datë 12.05.2022 kanë paraqitur kërkesën e tyre”, Komisioneri vlerëson se edhe ky argument nuk qëndron.

Nga shqyrtimi i kërkesës për informacion konstatohet se, si bazë ligjore të saj kërkuesi ka vendosur LDI, duke e konsideruar atë si informacion publik, dhe jo si një subjekt i interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi, për të cilën rrjedhimisht edhe mund të qëndronte argumenti i sipërcituar. Megjithëse në këtë njoftim nuk rezulton që të jetë publikuar një afat përfundimtar për marrjen e informacionit të kërkuar nga palët e interesuara.

LDI, edhe pse jo të shprehur në mënyrë literale, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: 1) *informacioni që bëhet publik pa kërkesë dhe 2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar.* Në kategorinë e parë, përfshihen ato kategori informacioni, të cilat publikohen dhe vendosen në dispozicion nga autoriteti publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti (sipas pikës 1 të nenit 7 të LDI), ndërsa rasti konkret objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë, pasi kemi të bëjmë me një kërkesë për informim të depozituar pranë Autoritetit Publik, në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI.

Gjatë hetimit administrativ, Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të legjitimojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik, për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik në kundërshtim me LDI.

Nga praktikatat e administruara nga Zyra e Komisionerit, konstatohet se Komisioneri ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme, vendimmarrje të cilat kanë mbetur në fuqi edhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit “*informacion publik*”

konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik". Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit objekt ankese, ngarkon me përgjegjësi Autoritetin Publik për vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

E drejta për informim, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t'i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *"Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore..."*.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1168 Prot., datë 10.06.2022, nga z. _____, kundër Autoritetit Publik "Avokatura e Shtetit", me objekt *"Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare"*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas ankesës nr. 1168 Prot., datë 10.06.2022, brenda datës 07 .07 .2022.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u shpall sot në datë 30 . 6 .2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

